



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 762/2 Prot.

Tiranë, më 25.05.2021

V E N D I M

Nr. 84, Datë 25 / 05 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 90, datë 17.05.2021, të paraqitur nga K.N kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në vitin 1984 është strehuar në qytetin e Peshkopisë, në një apartament 1+1, si punonjës që kishte kontribuar në ndërtimin e pallatit me kontribut vullnetar të ndërmarrjes së mermerit Muhur. Në vitin 1991 për shkak të situatës së rëndë, pasi një fëmijë e kishte të sëmurë të shëndetit mendor, i cili ishte i dhunshëm dhe kishte dhe tre fëmijë të tjerë, kolektivi i ndërmarrjes së bonifikimit i dhanë të drejtën për strehimin e tre fëmijëve dhe gruas në pallatin që do të ndërtohej me kontribut vullnetar, duke i dhënë një autorizim që kur të ndërtohej pallati, fëmijët dhe gruaja të kalonin në këtë pallat dhe ai të qëndronte në shtëpinë e tij që kishte banuar që nga viti 1984. Pas ngjarjeve të vitit 1990, pallati i ri mbeti i papërfunduar, prandaj ankuesi u detyrua të

¹ Ankuesi deklaroi se rrjedh nga një familje të persekutuarish politikë.

përfundonte punimet me shpenzimet e tija dhe strehoi gruan dhe tre fëmijët, ndërkohë që vetë bashkë me djalin e sëmurë, qëndronte tek apartamenti i vjetër. Pas kësaj periudhe ankuesi emigroi në Greqi. Në muajin shtator 1993 është kthyer nga Greqia dhe kur ka vajtur për të bërë pagesën e qerasë në ndërmarrjen Komonale Banesa Peshkopi, e kanë informuar që të mos paguaj për muajin tetor sepse ishte privatizuar apartamenti nga E.M, dhe i kanë dhënë vërtetimin e privatizimit. Për këtë veprim, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Dibër në të cilin ka kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së lidhur mes Ndërmarrjes Komonale Banesa me E.M, për banesën në të cilën kishte jetuar prej 9 vitesh. Gjykata e Rrethit Dibër me Vendimin nr. 407, datë 12.11.1993 ka vendosur rrëzimin e padisë së K.N, vendim i cili është kundërshtuar nga ankuesi. Gjykata e Apelit me Vendimin nr. 407, datë 06.04.1994 ka vendosur pushimin e gjykimit. Ankuesi duke mos rënë dakord me vendimin, i është drejtuar disa institucioneve, si: Ministrisë së Drejtësisë, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit, por nuk ka gjetur zgjidhje. Ankuesi kërkon nga Komisioneri që ta ndihmojë për rigjykimin e çështjes së tij, pasi atij i është marrë shtëpia pa marrë pjesë në gjykim, pa mbrojtjen e avokatit të shtetit, pa dërguar dokumentet e tija në apel nga Gjykata e Rrethit Dibër”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ti kthehet vlera e shtëpisë dhe vlera e qirasë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7/1 i LMD-së², parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirisë dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Diskriminimi synon respektimin me rigozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në vijim, ankuesi me datë 19.05.2021, është paraqitur pranë institucionit të Komisionerit dhe me anë të një kërkesë me shkrim ka kërkuar tërheqjen e ankesës për arsye familjare, ligjore dhe për çështje të tjera shoqërore.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Tërheqja e kërkesës.....: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga K.N, i cili me anë të kërkesës, datë 19.05.2021 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 90, datë 17.05.2021, paraqitur nga K.N kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA